

VENDIM
Nr.159, datë 30.3.2007

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2007, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE
PËR KURIMIN, NË ITALI, TË Z.BASHKIM GAZIDEDË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit Republikës së Shqipërisë” dhe të neneve 8 e 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006, “Për buxhetin e shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, në programin “Administrim, planifikim, menaxhim”, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 4 000 000 (katër milionë) lekësh, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve për kurimin, në Itali, të z.Bashkim Gazidede.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Pagesa të kryhet pas paraqitjes së faturave përkatëse.

4. Vendimi nr.796, datë 27.11.2006 i Këshillit të Ministrave shfuqizohet.

5. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha